GJYKATA THEMELORE GJAKOVË,- DEGA NË RAHOVEC/Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me pjesmarrjen e sekretares juridike Shemsije Shehu, duke vendosur në lëndën penale kundër të pandehurës E. H. nga fshati P., Komuna e Rahovecit, për shkak te veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 para 2 lidhur me par. 1 të KPRK-se, sipas propozimit për shqiptimin e masës se trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, PP/II.nr.1766/2018 të datës 11.01.2019, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar dhe publik në prezencën e përf. të akuzës prokurorit te shtetit Armend Zenelaj, të pandehurës E. H. dhe mbrojtësit të saj avokatit R. H., sipas detyrës zyrtare, me datën 19.11.2019, muarr këtë:

A K T V E N D I M

KUNDËR:

E. H. nga i ati V., dhe e ëma Z., e lindura K., e lindur më ..., në fshatin P., Komuna e Rahovecit, ku edhe jeton, e pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, e pa punë, e gjendjes se dobët ekonomike, Shqiptare, Shtetase e R. Kosovës.

Se më datën 26.11.2018, rreth orës 10:00 minuta, në fshatin P., Komuna e Rahovecit, pikërisht në shtëpinë e saj, duke vepruar në gjendje të paaftësisë mendore për të kuptuar dhe kontrolluar veprimet e veta, shkakton dhunë në familje sipas nenit 2 nën par. 1.2. pika 1.2.4 të Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, duke përdor forcën i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit – të atit të saj V. H., në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshjeve paraprake në mes vete e sulmon të dëmtuarin, respektivisht e gjuan dhe godet me një mjet të fortë – filgjan në fytyrë, me ç'rast i shkakton lëndime të lehta trupore sipas ekspertizës mjeko – ligjore të datës 26.12.2018 të Dr. F. D..

- Me këtë veprim, *në gjendje të paaftësisë mendore*, ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 pas. 2 lidhur me parag. 2 nënpar. 1.4 të KPRK-se.

Gjykata në kuptim të dispozitës së neneve 83,84, paragrafi 1.pika 1.2, nenit 86 para 1 pika 1.1 te KPK-se, të pandehurës, **i shqipton**:

MASËN E TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM PSIKIATRIK NË LIRI

- Obligohet e pandehura E. V. H. nga fshati P., Komuna e Rahovecit, qe te paraqitet ne Qendrën e shëndetit Mendore ne Gjakove, për trajtim të mëtutjeshëm psikiatrik.

-Obligohet Qendra e Shëndetit Mendore e Spitalit Rajonale " I. G. " në Gjakove, qe te pranoi te pandehurën E. V. H., për trajtim te mëtutjeshme psikiatrik, dhe kohe pas kohe te njoftoi Gjykatën mbi gjendjen shëndetësorë dhe suksesin e trajtimit te saj, e se paku një here ne gjashte muaj.

- Kjo masë do të jetë në fuqi deri në krijimin e kushteve për zëvendësimin e të njëjtës, përcjelljen dhe zbatimin e kësaj mase do ta ekzekutoi shërbimi sprovues ne Gjakove.

I dëmtuari V. A. H. nga fshati P., Komuna e Rahovecit, udhëzohen ne procedure te rregullt civile për realizimin e kërkesës pronësore juridike.

Shpenzimet e procedurës penale biejnë në llogari të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Gjakove, - Departamenti i Përgjithshëm, Gjykatës Themelore Gjakovë – Dega në Rahovec - Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr. 1766/2018 të datës 11.01.2019, për shkak te veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188/2-1-1.4 te KPRK-se,

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datën 19.11.2019, ku prezent ka qenë përf. I akuzës Prokurori i Shtatit Armend Zenelaj, e pandehura E. H. së bashku me mbrojtësin – avokatin R. H. sipas detyrës zyrtare i dëmtuari V. H. dhe eksperti Forenzikës psikiatrike në Prishtinë Dr. A. G..

Në fillim të seancës se shqyrtimit fillestare përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Armend Zenelaj, ka deklaruar se pasi qe Gjykata ka siguruar raportin – ekspertizën nga Instituti i Psikiatrisë në Prishtinë, mbi gjendjen e shëndetit mendore te te pandehurës E. H., përkitazi me te cilën kjo Prokurori ka ngritur aktakuzën PP/II.nr. 1766/2018 të datës 11.01.2019, e pasi qe nga raporti i Institutit te psikiatrisë Forenzike ne Prishtinë, është konstatuar se e pandehura E. H., ka shfaqur simptomotalogji të kualitetit psikotik. E ne baze te dispozitave te nënti 86 te KPRK-se, dhe nenit 512 te KPPK-se, andaj i propozoi Gjykatës që të njëjtës ti shqiptoj masën e trajtimit te detyrueshme psikiatrik ne Liri.

Përf. i akuzës prokurori Shtetit Armend Zenelaj, në tërësi ka ngelur pranë propozimit për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri në institucionin shëndetësor nga se këtu e pandehura ka kryer vepra penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188/2-1-1.4 te KPRK-se, e njejta ka pranuar fajësinë për këtë vepër penale dhe se deklarimi i sajë rreth pranimit te fajësisë bazohet ne provat materiale qe janë ne propozim për shqiptimin e masës dhe atë deklaratën e te dëmtuarit V. H., shikimit te raportit te oficerit foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes. si dhe provat tjera dokumentacioni mjekësor për të pandehurën E. H. nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë – QKUK e datës 18.12.2018, ku nga kjo ekspertize është konstatimi se e pandehura është person e cila vuan nga çrregullimi akut, psikotik i ngjashëm me skizofrenim që në klasifikimin ndërkombëtar të sëmundjeve ICD 10 kodohet me shifrën F23.2, ka histori te me parme te trajtimit te hospitalore dhe ambulator, posedon dokumentacion mjekësore dhe se aftësia për kontrollimin e veprimeve te saja kanë qenë esencialisht e zvogëluar, andaj i kanë propozuar Gjykatës që të njëjtës ti shqiptohet masa e trajtimit mjekësor psikiatrik ne liri, e cila do te realizohet ne Qendrën e Shëndetit Mendore ne Gjakovë.

Mbrojtësi i të pandehurës – avokati R. H. ka deklaruar, pasi qe e mbrojtura ime është deklaruar ne lidhje me rastin mua me mbeti vetëm te pajtohet me deklaratën e saj, pasi qe zgjidhja është më e mirë që kjo qeshje te përmbyllet për shkak te gjendjes së saj sociale shëndetësore, andaj pajtohem me propozimin e prokurorit për shqiptimin e masës trajtimit te detyrueshme psikiatrike ne liri.

Gjykata në cilëson e ekspertit është mare në pyetje Dr. A. G. ekspert i Forenzikës Psikiatrike në Prishtinë, i cili ka deklaruar se: e pandehura është ekzaminuar në mënyrë hospitalore në institut dhe është bazuar në intervistat ekipore dhe individuale të dhëna nga shkresat e lëndës, vlerësimit psikologjik dhe analizave laboratorike si dhe CT dhe EG, në bazë të këtyre të dhënave kemi konstatuar se ekzaminuara është person që aktualisht vuan nga çrregullimi akut psikotik i ngjashëm me kizofreni që në klasifikimin ndërkombëtarë të sëmundjeve kodohet me shifrën P23.2, ky çrregullim ka ecuri akute, natyrë të përkohshme dhe intensitet nga mesatarja në teren, karakterizohet me dëmtime të funksioneve kognitive me theks të veçantë dëmtime përmbajtjesore në të menduar në formë të deligjioneve, bazuar në këto të dhëna në momentin e kryerjes së veprës për të cilën akuzohet ka qenë në gjendje të pa aftësisë mendore për të kuptuar dhe kontrolluar veprimet e veta. Dhe krejt në fund duke marrë parasysh natyrën e çrregullimit kemi rekomanduar shqiptimin e masës së sigurisë trajtim i detyrueshëm psikiatrik në liri në institucionin më të afërt ku ofrohen shërbime psikiatrike.

Gjykata pas marrjes së ekspertizës nga ana e ekspertit nga klinika e psikiatrisë raporti i psikiatrisë Forenzike në Prishtinë P.nr. 27/2018, te dt. 18.09.2014, ku nga Mjeku eksperti te psikiatrisë Dr. A. G., (psikiatër Forenzik), Dr. F. D. (Neuropsikiatër), dhe B. V. (Psikologe Klinike), nga Instituti i Psikiatris Forenzike në Prishtinë, të datës 18.12.2018 ku nga kjo ekspertize është konstatimi se se e pandehura është person e cila vuan nga çrregullimi akut, psikotik i ngjashëm me skizofrenim që në klasifikimin ndërkombëtar të sëmundjeve ICD 10 kodohet me shifrën F23.2, ka histori te me parme te trajtimit te hospitalore dhe ambulator, posedon dokumentacion mjekësore dhe se aftësia për kontrollimin e veprimeve te saja kanë qenë esencialishtë e zvogëluar, andaj i kanë propozuar Gjykatës që të njëjtës ti shqiptohet masa e trajtimit mjekësor psikiatrik ne liri, e cila do te realizohet ne Qendrën e Shëndetit Mendore ne Gjakovë.

Andaj gjykata nga e cekur më lartë ndaj të pandehurës ka shqiptuar masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, komfort dispozitave te nënti 84, para 1 nen para 1.2 lidhur me nenin 20 para 1 nen para 1.1. te KPPK-se, dhe nenit 513 para 1 lidhur me para 2 te KPPK-se.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e bazoi në dispozitat e nenit 453 paragrafi 2 i KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.27/2019 me datën 19.11.2019.

Sekr. Juridike **Gjyqtari i vetëm Gjykues**
Shemsije Shehu **Mizahir Shabani**

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 8 nga dita e pranimit nëpërmjet kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.